

Thirrje për projekt propozime në kuadër të projektit "Bashkimi Evropian për Përfshirjen në Tregun e Punës" (EU4LMI)

Projekti "Bashkimi Evropian për Përfshirjen në Tregun e Punës" (EU4LMI) 2024-2026 është një projekt i financuar nga BE si pjesë e Programit të BE-së për Përfshirjen Sociale nën IPA 2019, që po zbatohet nga UNDP në Shqipëri (udhëheqës projekti) dhe nga partnerët: Shërbimet Publike Suedeze të Punësimit (Arbetsförmedlingen) dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHHPAK).

Projekti "Bashkimi Evropian për Përfshirjen në Tregun e Punës" (EU4LMI) ka si qëllim forcimin e partneritetit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) me bashkitë dhe aktorët e tjerë të tregut të punës për të krijuar dhe ofruar mundësi gjithëpërfshirëse dhe të integruara punësimi dhe zhvillimi aftësish për grupet vulnerabël.

Në kuadër të këtij Projekti, UNDP ka shpallur thirrjen për projekt propozime si më poshtë:

Informacione kryesore:

- Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve: 30 shtator 2024
- Buxheti total i disponueshëm: 1,200,000 EUR (i alokuar sipas LOT-ëve: LOT I – EUR 660,000, LOT II – EUR 290,000, LOT III – EUR 250,000)
- Financimi për çdo grant: Minimumi 60,000 EUR - maksimumi 200,000 EUR
- Kohëzgjatja e projekteve: 8-18 muaj
- Zbatimi në: 19 bashki të targetuara (Prrenjas, Gjirokastra, Vora, Mallakastra, Cerrik, Librazhd, Shijak, Kavaja, Kurbin, Kukes, Kruja, Pogradec, Korca, Kamza, Vlora, Shkodra, Elbasan, Durres and Tirana).
- Mbështetja financiare do të mbulojë 100% të kostove të tyre të pranueshme (d.m.th. nuk kërkohet bashkëfinancim). Buxheti i propozimit të dorëzohet në Lekë.

Objektivat e thirrjes (sipas LOT-ëve):

- LOT 1: Krijimi dhe ofrimi i Këshillimit Intensiv për Punësim
LOT 1 synon të mbështesë AKPA-të për të zgjeruar në bashki të tjera modelin efektiv të krijuar në lidhje me këshillimin intensiv për punësim, duke synuar 600 punëkërkues nga kategoritë e synuara në 19 bashkitë e targetuara.
- LOT 2: Krijimi dhe ofrimi i trajnimeve cilësore, fleksibël dhe të targetuara në aftësitë bazë
LOT 2 synon të ofrojë kurrikulat e zhvilluara për 600 persona të papunë afatgjatë nga grupi i synuar, të cilët kanë nivel të ulët aftësish ose nuk kanë përfunduar arsimin bazë.
- LOT 3: Krijimi dhe ofrimi i programeve të punësimit dhe zhvillimit të aftësive me mbështetje për personat me aftësi të kufizuara

LOTI 3 synon të mbështesë përfshirjen sociale dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre duke financuar modele inovative të punësimit të mbështetur dhe zhvillimit të aftësive, duke kapitalizuar përvojën e aktorëve lokalë dhe duke forcuar kapacitetet e AKPA-së për menaxhimin e programeve të tilla.

Aplikantët e pranueshëm:

- Njësitë e Qeverisjes Vendore (19 bashkitë e targetuara)
- Organizata të Shoqërisë Civile
- Ndërmarrjet sociale

Grupet përfituese:

1. Të rinjtë që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim (NEET) (15-29 vjeç)
2. Nënata e reja të papuna
3. Përfituesit e ndihmës ekonomike
4. Personat me aftësi të kufizuara

Seancat informuese të përgjithshme do të mbahen online në datat 27 dhe 29 gusht 2024. Regjistrohuni në linkun e mëposhtëm për të marrë pjesë: https://undp.zoom.us/webinar/register/WN_VAZqmlUVRRa2s-ag24fvAg Dhe me pjesëmarrje fizike më datë 04.09.2024, ora 11:00, pranë Europe House, Tiranë.

Si dhe seanca informuese të dedikuara që do të mbahen në Vlorë: 02.09.2024 ora 11:00, AKPA rajonale Vlorë; Gjirokastër: 03.09.2024, ora 11:00, AKPA rajonale Gjirokastër; Shkodër: 10.09.2024, ora 11:00, AKPA rajonale Shkodër; Pogradec: 12.09.2024, ora 11:00, Zyra e Punësimit Pogradec; Elbasan: 13.09.2024, ora 10:00, AKPA rajonale Elbasan; Kukës: 16.09.2024, ora 11:00, AKPA rajonale Kukës.

Pyetjet dhe kërkesat për sqarime mund të dërgohen deri më 9 shtator 2024 në adresën e emailit: eu4lmi.al@undp.org

Për më shumë informacion dhe udhëzime të detajuara për aplikim, ju lutemi referojuni dokumentit të plotë të thirrjes për propozime të publikuar në linkun e mëposhtëm: <https://www.undp.org/albania/news/call-proposals-framework-eu-labour-market-inclusion-project>